



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

## UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 01, datë 7.11.2024

### PËR

## MËNYRËN E BASHKËPUNIMIT MES KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË GJENDJES CIVILE PËR ÇREGJISTRIMIN E SHTETASVE QË VOTOJNË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË LISTËN E ZGJEDHËSVE BRENDA VENDIT

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2 të nenit 19, të pikës 13 të nenit 25, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, Ministri i Brendshëm dhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

### UDHËZOJNË:

#### I. Rregulla të përgjithshme

1. Zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë, duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është një listë e vetme në nivel zone zgjedhore dhe përmban listën e shtetasve shqiptarë që kanë shprehur vullnetin të votojnë nga jashtë vendit dhe që janë regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (në vijim “RKGJC”) në territorin e zonës zgjedhore përkatëse.

3. Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë hartohet dhe përdoret rishtazi për çdo proces zgjedhor për Kuvendin e Shqipërisë sipas kritereve, procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe aktet normative të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në vijim “KQZ”), dhe është e vlefshme vetëm për zgjedhjet për të cilat është hartuar.

4. Në çdo rast, KQZ dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (në vijim “DPGJC”) ruajnë bazën e të dhënave të zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për çdo proces zgjedhor.

5. Të dhënat për adresën dhe dokumentacioni që konfirmojnë qëndrimin e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, miratohen me vendim të Rregullatorit.

## **II. Mënyra e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit, me qëllim hartimin e listës së zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe çregjistrimi i këtyre zgjedhësve nga lista e zgjedhësve brenda vendit ndërmjet institucioneve shtetërore të përfshirë.**

1. Regjistrimi i zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitja e listës së këtyre zgjedhësve bëhet sipas rregullave të përcaktuara me akt normativ të Komisionit Rregullator.

2. Kërkesat për regjistrim kryhen përmes Platformës Elektronike të Regjistrimit (në vijim referuar si “PER”), sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor.

3. Gjatë periudhës së hartimit të listës së zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, KQZ-ja komunikon me DPGJC-në përmes ndërveprimit automatik elektronik në kohë reale midis PER dhe RKGJC.

4. Të dhënat e identitetit të shtetasit, të marra gjatë procesit të paraqitjes së kërkesës për regjistrim në PER, verifikohen nga KQZ në RKGJC. Nëse ato janë të njëjta, DPGJC bën regjistrimin në RKGJC të adresës së shtetasit që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në një rubrikë të veçantë.

5. Të dhënat për adresën e banimit që do të kërkohen gjatë procesit të regjistrimit nga ana e zgjedhësit dhe që do të transmetohen në RKGJC janë: shteti, qyteti, emërtesa e rrugës, numri i banesës, elemente të tjera të adresës (nëse ka), dhe kodi postar.

6. Çdo informacion që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve transmeton tek Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si pjesë e procedurave për përgatitjen e listës së zgjedhësve nga jashtë vendit, do të përdoret nga DPGJC vetëm për qëllime që lidhen me mundësimin e votimit për këta zgjedhës.

7. Në përfundim të procesit të regjistrimit të kërkesave të zgjedhësve për të votuar nga jashtë vendit, sipas afateve të përcaktuara me vendim të Komisionit Rregullator, DPGJC nxjerr nga RKGJC listën paraprake të zgjedhësve nga jashtë vendit dhe ia dërgon atë në format elektronik Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, jo më vonë se 63 ditë para datës së zgjedhjeve.

8. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, 63 ditë para datës së zgjedhjeve, publikon listën paraprake të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit, me qëllim që zgjedhësit brenda 48 orëve nga publikimi i saj të mund të kërkojnë regjistrimin apo rregullimin e pasaktësive të regjistrimit të tyre në PER.

9. Në përfundim të procesit të përmendur në pikat 7 dhe 8 të kreut II të këtij udhëzimi, DPGJC nxjerr nga RKGJC listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë vendit dhe ia dërgon atë në format elektronik KQZ-së menjëherë, por jo më vonë se 61 ditë para datës së zgjedhjeve.

10. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, 60 ditë para datës së zgjedhjeve, miraton dhe publikon në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, listën përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit.

11. Shtetasit shqiptarë që janë regjistruar në listën e zgjedhësve jashtë vendit, pas përfundimit të procedurës së regjistrimit sipas këtij udhëzimi dhe miratimit e publikimit të listës përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, çregjistrohen nga lista e zgjedhësve brenda vendit që shpallet sipas nenit 56 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

12. DPGJC monitoron dhe merr masa për zbatimin e veprimtarisë së pasqyrimin të ndryshimeve përkatëse në listën e zgjedhësve, për çregjistrimin dhe heqjen nga kjo listë të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

13. Ndryshimet në listën e zgjedhësve pasqyrohen në ekstraktin e parë të listës së zgjedhësve, që del pas publikimit të listës përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit, nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

### **III. Mbikëqyrja dhe kontrolli i procesit**

1. Auditët teknicienë, të miratuar sipas nenit 61 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kryejnë verifikimin e veprimeve të kryera nga KQZ për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë vendit, duke filluar 120 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

### **IV. Dispozita të fundit**

1. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Bashkitë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative. si dhe institucionet e tjera shtetërore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për ndjekjen e zhvillimeve të nevojshme teknike në RKGJC, që lindin nga zbatimi i këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I BRENDSHËM**

**Ervin Hoxha**

**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Ilirjan Celibashi**